

Informata rreth aplikimit në Programin e KEDS Academy

24 TETOR 2022

Kur mund te aplikoni?

Duke filluar nga data 24 Tetor 2022 deri me datë 11 Nëntor 2022

Ku mund te aplikoni?

Në Zyrën Qendrore të KEDS në Bulevardin Bill Clinton Nr. 5 në Prishtinë, ose në e-mail adresën apply@keds-energy.com.

Kush mund te aplikojë?

Studentët e Universiteteve Publike në Republikën e Kosovës që janë duke ndjekur ligjëratat e vitit të fundit akademik, viti i tretë i studimeve, si dhe Nxënësit e Shkollave të Mesme Profesionale Viti i fundit i shkollimit (klasa e 12).

Të drejt aplikimi kanë studentët dhe nxënësit sipas drejtimeve/ profileve në vijim:

FAKULTETI	DREJTIMI	NOTA MESATARE
Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike	- Elektroenergjetikë	6.5
	- Inxhinieri Kompjuterike	7.5
Ndërtimtari	- Konstrukione	6.5
Shkenca Matematikore	- Matematikë	7.0
Juridik	- Juridik i Përgjithshëm	8.0
Inxhinieri Mekanike	- Komunikacion dhe transport	7.0
Ekonomik	- Menaxhement	7.5

SHKOLLA E MESME PROFESIONALE	PROFILI	NOTA MESATARE
Drejtimi Elektroteknikë	- Profili Energjetikë - Instalues Elektrikë - Makina Elektrike	3.0

Kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen e studentëve:

- Shkathhtësi të mira në përdorimin e Teknologjisë Informative.
- Shkathhtësi të mira të komunikimit.
- Njohja e gjuhës angleze e **obligueshme**.

Kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen e nxënësve:

- Suksesi në vitin paraprak (minimum me sukses të mirë).
- Shkathhtësi të mira në përdorimin e Teknologjisë Informative.
- Shkathhtësi të mira të komunikimit.
- Njohja e gjuhës angleze përparësi.

Pse duhet te aplikoni?

Që të përfitoni njohuri/ shkathtësi për integrim më të lehtë në tregun e punë si dhe për zhvillim të vazhdueshëm profesional. Një mundësi më shumë në përfitimin e përvojave dhe ekspertizës vendore dhe ndërkombëtare. Mundësi për tu inkuadruar në tregun vendor dhe ndërkombëtar.

Çka ju nevojitet për aplikim?

Për studentët e Universitetit

Formulari i plotësuar i shkarkuar nga web faqja e KEDS Academy.

Transkripti i notave për vitin paraprak.

Dëshmi (vërtetim) se jeni student i rregullt në vitin e tretë akademik.

Si dhe dëshmi tjera të përshkruara në formularin e aplikimit.

Për nxënësit e shkollave të mesme

Formulari i plotësuar i shkarkuar nga web faqja e KEDS Academy.

Certifikata e notave për vitin paraprak (klasa 11).

Si dhe dëshmi tjera të përshkruara në formularin e aplikimit.

Si mund te aplikoni?

Për të aplikuar, luteni të plotësoni formularin e aplikimit të cilin mund ta shkarkoni në webfaqen e KEDS www.keds-energy.com.

Pas aplikimit

Kandidatet të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara më lart mund të hynë në garë për të qenë pjesë e programit. Kandidatët e përzgjedhur do të kalojnë nëpër një proces të vlerësimit si: test me shkrim dhe intervistë me gojë. Kandidatët të cilët do të tregojnë rezultat pozitiv në testin me shkrim do të nënshtrohen intervistës me gojë. Pas fazës së intervistimit kandidatët e suksesshëm do të konsiderohen pjesë e programit.